



## KOMUNIKATË

**29.10.2009**

Kryetarja e KQZ-së, Nesrin Lushta, së bashku me Drejtorin Regjional të IFES-it, Chedomir Flego dhe Kryetarin e Shoqatës së të Verbërve dhe me të parë të dobësuar, Bujar Kadriu, kanë mbajtur një konferencë për Media në selinë e Komisionit Qendror Zgjedhor lidhur me përdorimin e Shablloneve të Votimit për të Verbërit. Me anë të këtij shablloni, u mundësohet votuesve me pengesa në shikim, pjesëmarrjen e barabartë në procesin e votimeve.

Kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, ka thënë me këtë rast se KQZ ka aprovuar Projektin e votimit për të verbrit dhe kjo sipas saj, ka një rëndësi të madhe sepse për herë të parë personat e verbër do votojnë në tërë territorin e Kosovës me Alfabetin e Brajit. “Kjo kategori pa ndihmën e askujt do të mund të votoj duke shfrytëzuar materialet e posaçme të shtypura me alfabetin e Brajit. Në secilën qendër të votimit do të ekzistojë nga një shablloni tillë dhe në secilin qendër do të ekzistoj nga një vendvotim i tillë ku këta persona do të mund të votojnë në mënyrë të pavarur”, ka shpjeguar në këtë konferencë kryetarja Lushta.

“Personat e tillë do të mund të votojnë në alfabetin e Brajit por edhe në mënyrën tjetër me ndihmën e personit tjetër. Për KQZ-në është me rëndësi që kjo mundësi t’u ofrohet të gjithëve”, ka thënë znj. Lushta.

Kryetari i Shoqatës së të Verbërve dhe me të parë të dobësuar, z. Bujar Kadriu ka shpreh konsideratën e tij të lartë për KQZ-në. “KQZ ka marrë një vendim shumë kapital kur ka bërë barazimin e shqiptarëve për të votuar. Ky barazim reflekton drejt për drejt synimet e Kosovës për t’i përmbush standardet demokratike. Me këtë rast nuk duhet të jetë krenar vetëm shqiptari i verbër por duhet të bëhen krenar institucionet e Kosovës të gjithë mekanizmat dhe të gjithë akterët që kanë ndihmuar këtë proces i cili Kosovën, e ka radhitur si një ndër vendet më demokratike, që respekton të drejtat e njeriut në këtë rast të drejtat e votimit konfidencial. Apeloj te të gjithë të verbërit dhe ata me të pame të dobësuar që të dalin në votime në mënyrë masive pa asnjë hezitim. Për herë të parë në historinë e tyre, e kanë mundësinë për të votuar kandidatin e preferuar. Ky është një angazhim serioz i KQZ-së dhe një përvojë e madhe e IFES-it dhe të gjithë mekanizmave që kanë ndihmuar në këtë proces”, ka thënë në konferencë z. Kadriu.

Drejtori Regjional i IFES-it, Chedomir Flego ka thënë: “Shabllonet të dizajnuara me ndihmën e IFES-it, do t’u mundësojnë personave të verbër dhe me të parë të dobësuar, të marrin pjesë në procesin e votimit pa e rrezikuar konfidencialitetin e votuesit. Të gjithë votuesit që kanë pengesa në shikim, do të trajtohen në mënyrë të barabartë. Ky program

do t'i trajnojë dhe do t'i pajisë të gjitha vendvotimet në mënyrë që ato t'u shërbejnë votuesve të verbër sipas nevojës”.

Për të rritur vetëdijen e opinionit publik, do të mbahen dymbëdhjetë (12) seminare me qëllim të inkurajimit të votuesve me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në zgjedhje. Seminaret do të mbahen nëpër tërë Kosovën.